Ne lidhje me kerkesen per informacion dhe venien ne dispozicion te dokumentacionit, drejtuar Institucionit te Avokatit te Popullit, ku kerkoni:

1. Sa eshte numri I ankesave qe jane drejtuar Avokatit te Popullit kunder Qendres Kombetare te Trajtimit te Viktimave te Dhunes ne Familje per vitet 2016-2017 dhe na vini ne dispozicion nje kopje te tyre?
2. Cfare ka vendosur Avokati I Popullit ne lidhje me abkesat dhe cilat jane rekomandimet e marra per secilin rast?

Ju informojme se, Avokati I Popullit ne vite ka trajtuar ankesa dhe ka kryer inspektime periodike qe lidhen me mirefunksioninimin e kesaj qendre sipas kuadrit ligjor vendas dhe standarteve te parashikuara ne konventat nderkombetare ne kete fushe.

I) Per periudhen qe ju permendni ne kerkesen tuaj, nuk rezultojne ankesa te rregjistruara nga individe ose subjekte te interesuara, por nje grupi pune i Institucionit te Avokatit te Popullit në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të njeriut, **më datë 9.02.2017**, kanë kryer inspektimin në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje në Kamëz.

Gjatë këtij inspektimi, janë konstatuar problematikat e mëposhtme:

1. **Nuk ka Psikolog, i domosdoshëm për të kategorinë që strehohet dhe problematikat që u rezultojnë si viktima dhune, me synim rehabilitimin e tyre.**
2. **Nuk ka Jurist me kohë të plotë, por mbulohet me part-time. Problematikat sidomos në rastet e zgjidhjes së martesave, lidhur me ndarjen e pasurisë bashkëshortore, e për të cilat nevojitet asistencë ligjore e paraqesin si domosdoshmëri këtë shtesë personeli.**
3. **Automjeti ishte shumë i vjetër dhe i amortizuar, dhe në të mirë të ofrimit të këtij shërbimi do të ishte e nevojshme pajisja me një furgon-mikrobuz për lëvizjet e mundshme të grave-përfituese në punë, e cila mund të jetë me dy turne (e po ashtu lëvizjet mund të jenë qoftë për proceset gjyqësore në Gjykata, në spitale, takimet në burg, për mbledhje dokumentacioni, etj). Punonjësit e Institucionit përdorin linjën urbane Kamëz-Tiranë, pasi automjeti shërben vetëm për përfitueset.**
4. **Çatia e Qendrës ishte e pariparuar, kishte lagështirë, ndaj nevojitej rikonstruksioni i saj. Por mungonte fondi i investimit përkatës.**
5. **Domosdoshmëria e shtimit të kuotës ditore ushqimore, si pasojë e rritjes në vite të çmimeve të ushqimeve. E po ashtu një fond pë aktivitete sociale.**
6. **Po ashtu problem i konstatuar ishte problemi i blerjes së medikamenteve të shtrenjta për të sëmurët kronikë apo fëmijët me viroza të rënda, të cilat nuk mund të parashikohen kur planifikohet buxheti i Qendrës. Mjeku me kohë të plotë kur ishte e nevojshme jepte recetë medikamentesh, por jo të rimbursueshme, pasi nuk ishte mjek i familjes.**
7. **Nevoja e trajnimeve të stafit, pasi ka dhe staf të ri si punonjësi social, mjeku, psikologia, të cilat nuk ishin të trajnuara për specifikat e trajtimit të viktimave të**

dhunës në familje, për mundësimin e ndërgjegjësimit të tyre dhe riintegrimin e tyre me dinjitet në shoqëri.

8. **Qendra nuk kishte ngrohje qendrore, por dhomat ishin të pajisura me kondicionere.**

9. **Në turnin e 3 si dhe në dy ditët e pushimit javor, në Qendër qëndronte vetëm një punonjës (kujdestar apo edukator)**

10. **Lidhur me problemin e licensimit të kësaj Qendre, Institucioni ynë do të vijojë procesin e shqyrtimit administrativ për të gjitha detyrimet e palëve, në nivel vendor dhe qendror, dhe do ju vëmë në dijeni më pas. E po ashtu dhe të problemit të mungesës së çerdhes apo kopshtit publik me drekë në territorin e Bashkisë së Kamzës, që do të ndihmonte për përfituesit e mitur të kësaj qendre.**

Ne perfundim te inspektimit për të plotësuar standartet e përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", **ka Rekomanduar, znj. Etleva Bisha, Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe znj.Fatbardha Hoxhalli, Drejtore e Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje**:

Marrjen e masave për:

1. Hidroizolimin dhe riparimin e çatisë, mundësimin e akordimit të fondit të investimit përkatës si dhe pajisjen me një automjet të përshtatshëm të Qendrës, e cila trajton gra, vajza dhe fëmijë, viktima të dhunës në familje.
2. Shtimin e organikës me disa pozicione pune (psikolog, jurist dhe magazinier), si dhe vijimin e trajnimeve për stafin e ri të Qendrës .
3. Ndërmarrjen e iniciativës për indeksimin e kuotës ditore ushqimore, si pasojë e rritjes në vite të çmimeve të ushqimeve.

II) Gjithashtu **ne vitin 2016 institucioni i AP ka përgatitur nje Raport**, I cili eshte nje risi dhe përbën një analizë të arritjeve dhe boshllëqeve ligjore dhe faktike në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që i dalin shtetit shqiptar nga Konventa "Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", CEDAW në disa fusha, te cilin mund gjeni ne faqen zyrtare te internetit te AP ne adresen:

http://www.avokatipopullit. gov.al/sites/default/files/ RAPORTET/RAPORTE_TJERA/ Raporti%20mbi%20zbatimin%20e% 20konvet%C3%ABs%20CEDAW%20n% C3%AB%20Shqip%C3%ABri.pdf

Ne kete Raport do te gjeni dhe konkluzione me te plota per kete fenomen dhe ne vecanti per rolin e Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, ne kete drejtim.

Besojme se informacioni i dërguar eshte ne përputhje me kërkesat e lartepermendura ne shkresën tuaj dhe per cdo nevoje tjetër jeni te lutur te na drejtoheni përsëri.

Me respekt,

Besnik DEDA
Nd/Komisioner